



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2019, miratoi këtë:

**UDHËZIM METODOLOGJIK**  
**PËR RAPORTIMIN E KAPITALIT DHE KËRKESAVE TË KAPITALIT TË BANKAVE**

Data efektive: 1 janar 2020

Qëllimi i këtij udhëzimi metodologjik është të përcaktojë metodologjinë e raportimit të kapitalit rregullator, shumave të ekspozimeve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor dhe të kërkesave për kapital për rrezikun e tregut të bankave. Ky udhëzim metodologjik është përpiluar në funksion të zbatimit të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020.

## **I. KAPITALI RREGULLATOR I BANKAVE**

1. Formulari i kapitalit përmban shumën e kapitalit të bankave.
2. Totali i kapitalit të një banke përbëhet nga : Kapitali i klasës së parë (ang.Tier 1),përfshinë Kapitalin bazë të klasës së parë (ang. CET 1), Kapitalin shtesë të kapitalit bazë (CCB) dhe Kapitalin shtesë të klasës së parë (ang. AT1) si dhe Kapitali i klasës së dytë (ang. Tier 2).

**Tabela 1. Udhëzimet lidhur me pozicionet e veçanta për Kapitalin Rregullator**

<b>Rreshti</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
	<b>Kapitali bazë i klasës së parë i pranueshëm</b>
1	<p><b>Kapitali i paguar</b></p> <p>Kapitali i paguar duhet të jetë i barabartë me shumën e aksioneve të zakonshme dhe tepicës së lidhur me të. Kjo shumë duhet të jetë neto nga aksionet e thesarit dhe investimeve të tjera në aksionet e bankës deri në nivelin që këto janë të çregjistruara në bilancin e gjendjes sipas standardeve relevante të kontabilitetit. Elementet tjera të kapitalit të paguar duhet të përjashtohen. Interesi pakicë (i pa kontrolluar) duhet të përjashtohet plotësisht.</p> <p>Neni 7 dhe 8 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
2 = 2.1+2.2+2.3- 2.3	<p>Fitimet e pashpërndara (shuma e plotë para aplikimit të të gjitha përshtatjeve rregullative)</p> <p>Neni 7 dhe 8 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
2.1	Fitimet e pashpërndara të viteve të kaluara
2.2	Fitimi apo humbja e pranueshme
2.3	Fitimi i papranueshëm i periudhës raportuese apo i fund-vitit

3	Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar dhe rezervat tjera (shuma e plotë para aplikimit të zbritjeve)
4 = 1+2+3	Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë që i atribuohet zotëruesve të aksioneve të zakonshme të bankës mëmë

5	Gjithsej interesi pakicë i pranuar në Kapitalin Bazë të klasës së parë Neni 17, 18 dhe 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
6 = 4+5	<b>Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë para përshtatjeve rregullative</b>
	<b>Përshtatjet rregullative të Kapitalit bazë të klasës së parë</b>
7	Zbritja e humbjeve për vitin aktual financiar (të audituara dhe të pa audituara) Neni 22 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
8	Zbritja e emrit të mirë (ang. goodwill) neto nga detyrimet tatimore Neni 23 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
9	Zbritja e pasurive të paprekshme (duke përjashtuar emrin e mirë dhe të drejtat e servisimit të hipotekave) neto nga detyrimet tatimore Neni 23 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
10	Zbritja e mjeteve tatimore të shtyra si rezultat i bartjes nga periudhat paraprake e humbjeve tatimore të pashfrytëzuara, kredive tatimore të pashfrytëzuara dhe gjithë tjerat (neto nga pjesëmarrja e barabartë e çdo detyrimi tatimor të shtyrë) Neni 24 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
11	Zbritja e investimeve në aksionet e thesarit (duke përjashtuar shumat e çregjistruara sipas standardeve relevante të kontabilitetit) Neni 30 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
12	Zbritja e pjesëmarrjeve reciproke e Kapitalit aksionar Neni 31 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave

13	Zbritja për mungesën e provizioneve / rezervave ndaj humbjeve të pritura (bruto nga çdo rregullim tatimor) Neni 26 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
14	Rezerva mbrojtëse e rrjedhës së parasë e cila duhet të zbritet (apo mblidhe nëse është negative) nga Kapitali bazë i klasës së parë Neni 25 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
15	Gjithsej fitimet dhe (humbjet) neto kumulative në kapital për shkak të ndryshimeve në vlerën e drejtë të detyrimeve që rrjedh nga ndryshimi i rrezikut kreditor të bankës Shuma e cila duhet të zbritet (ose të mblidhet) nga kapitali (nëse është fitim duhet të raportohet si pozitiv; nëse humbje duhet të raportohet si negative) Neni 28 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
16	Zbritja e mjeteve të fondit pensional për përfitime të përcaktuara Neni 29 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
17	Zbritja e fitimeve në shitje nga transaksionet e sekjuritizimit (të ardhurat e ardhshme marginale të pritshme) Neni 27 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
18	Zbritjet për vlerësimin prudencial Neni 20 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
19	Zbritjet tjera nga Kapitali bazë i klasës së parë që duhet të bëhen para aplikimit të limiteve të zbritjeve
<b>20 = 6 – shuma e (7 deri në 19)</b>	<b>Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë pas përshtatjeve rregullative të mësipërme</b>
21	Zbritja e investimeve në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator dhe ku banka nuk ka në pronësi më tepër se 5% të kapitalit aksionar të zakonshëm (duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak) Neni 32 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave

22 = 20-21	<b>Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë pas përshtatjeve rregullative të mësipërme</b>
23	Zbritja e investimeve të konsiderueshme në kapitalin bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator (d.m.th., në rastet kur banka ka në pronësi më shumë se 5% të kapitalit të aksionar të zakonshëm të emetuar apo kur entiteti është filialë), duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak Neni 33 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
24	Zbritja e të drejtave të servisimit të hipotekave Neni 34 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
25	Zbritja e mjeteve të shtyra tatimore për shkak të diferencave të përkohshme (shuma mbi limitin prej 10%) Neni 34 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
26 = 22- 23- 24-25	<b>Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë pas përshtatjeve rregullative të mësipërme</b>
27	Përshtatjet rregullative që duhet të aplikohen ndaj Kapitalit bazë të klasës së parë për shkak të pamjaftueshmërisë së Kapitalit shtesë të klasës së parë për të mbuluar zbritjet
28	Shuma agregate subjekt i limitit prej 15% (investimet e konsiderueshme në institucionet financiare, të drejtat e servisimit të hipotekave dhe mjetet e shtyra tatimore që rrjedhin nga diferencat e përkohshme). Neni 34 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
29	Zbritja e pjesëmarrjeve kualifikuese jashtë sektorit financiar Neni 36 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
30	Zbritjet tjera të Kapitalit bazë të klasës së parë
31 = 6-32	<b>Gjithsej përshtatjet rregullative të Kapitalit bazë të klasës së parë</b>
32 = 26-27- 28-29-30	<b>Kapitali bazë i klasës së parë neto nga përshtatjet rregullative</b>
	<b>Kapitali shtesë i klasës së parë i pranueshëm</b>

33	<p>Instrumentet e Kapitalit shtesë të klasës së parë të emetuara nga banka mëmë e grupit (dhe çdo tepricë e ndërlidhur), duke përfshirë çdo kapital të pranueshëm të emetuar përmes entiteteve për qëllime specifike (ang. SPV)</p> <p>Neni 10 dhe 11 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
34	<p>Instrumentet që plotësojnë kriteret për Kapitalin shtesë të klasës së parë të emetuara nga filialet te palët e treta që janë të pranuar në Kapitalin shtesë të klasës së parë të grupit</p> <p>Neni 17, 18 dhe 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
35 = 33+34	<p><b>Gjithsej Kapitali shtesë i klasës së parë para përshtatjeve rregullative</b></p>
36	<p>Zbritja për investimet nga Kapitali shtesë i klasës së parë (duke përjashtuar shumat e çregjistruara sipas standardeve relevante të kontabilitetit)</p> <p>Neni 30 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
37	<p>Zbritja e pjesëmarrjeve reciproke nga Kapitali shtesë i klasës së parë</p> <p>Neni 31 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
38	<p>Zbritja e investimeve në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator dhe ku banka nuk ka në pronësi më tepër se 5% të kapitalit aksionar të zakonshëm (duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak)</p> <p>Neni 32 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
39	<p>Zbritja e investimeve të konsiderueshme në kapitalin bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator (d.m.th., në rastet kur banka ka në pronësi më shumë se 5% të kapitalit të aksionar të zakonshëm të emetuar apo kur entiteti është filialë), duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak</p> <p>Neni 33 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave</p>
40	<p>Zbritjet tjera nga Kapitali shtesë i klasës së parë</p>
41	<p>Përshtatjet rregullative në Kapitalin e klasës së dytë të cilat duhet të zbriten nga Kapitali shtesë i klasës së parë</p>
42 = 36+37+	<p><b>Gjithsej përshtatjet rregullative të Kapitalit shtesë të klasës së Parë; nga të cilat</b></p>

38+39 +40+41	
43 = min (35,42)	<b>Përshtatjet rregullative realisht të bëra në Kapitalin shtesë të klasës së parë</b>
44 = 35-43	<b>Kapitali shtesë i klasës së parë neto nga përshtatjet rregullative</b>
	<b>Kapitali i klasës së dytë</b>
	<b>Kapitali i klasës së dytë i pranueshëm</b>
45	Instrumentet e Kapitalit të klasës së dytë të emetuara nga banka mëmë e grupit (dhe çdo tepricë e ndërlidhur), duke përfshirë çdo kapital të pranueshëm të emetuar përmes entiteteve për qëllime specifike (ang. SPV) Neni 13 dhe 14 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
46	Instrumentet që plotësojnë kriteret për Kapitalin e klasës së dytë të emetuara nga filialet tek palët e treta që janë të pranuar në Kapitalin e klasës së dytë Neni 17, 18 dhe 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
47	Provizionet e përfshira në Kapitalin e klasës së dytë Neni 15 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
48	Zërat tjerë
49 = 45+46 +47+48	<b>Gjithsej Kapitali i klasës së dytë para përshtatjeve rregullative</b>
	<b>Përshtatjet rregullative në Kapitalin e klasës së dytë</b>
50	Zbritja e investimeve në Kapitalin e klasës së dytë (duke përjashtuar shumat e çregjistruara sipas standardeve relevante të kontabilitetit) Neni 30 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
51	Zbritja e pjesëmarrjeve reciproke nga Kapitali i klasës së dytë Neni 31 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
52	Zbritja e investimeve në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator dhe ku banka nuk ka në pronësi më tepër se 5% të kapitalit aksionar të zakonshëm (duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak)

	Neni 32 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
53	Zbritja e investimeve të konsiderueshme në kapitalin bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator (d.m.th., në rastet kur banka ka në pronësi më shumë se 5% të kapitalit të aksionar të zakonshëm të emetuar apo kur entiteti është filialë), duke përjashtuar shumat e mbajtura për qëllime të sipërmarrjeve të emetimit vetëm nëse mbahen 5 ditë pune apo më pak  Neni 33 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
54	Zbritjet tjera nga Kapitali i klasës së dytë
55=50+51 +52+53+54	<b>Gjithsej përshtatjet rregullative në Kapitalin e klasës së dytë; nga të cilat</b>
56 = min(49,55)	<b>Përshtatjet rregullative realisht të bëra në Kapitalin e klasës së dytë</b>
57 = 49-56	<b>Kapitali i klasës së dytë neto nga përshtatjet rregullative</b>

**Tabela 2. Provizionet dhe humbjet e pritura**

<b>Rreshti</b>	<b>Për portofoliot sipas qasjes së vlerësimeve të brendshme</b>
1	Gjithsej provizionet bruto që kualifikohen për përfshirje në përshtatjet e kapitalit në lidhje me diferencën në mes të humbjes së pritur dhe provizioneve
2	Gjithsej humbja e pritur që kualifikohet për përfshirje në përshtatjet e kapitalit në lidhje me diferencën në mes të humbjes së pritur dhe provizioneve
3	Mungesa e provizioneve ndaj humbjeve të pritura që duhet të zbritet nga Kapitali bazë i klasës së parë (bruto nga çdo rregullim tatimor)
4	Limiti maksimal për përfshirjen e provizioneve shtesë në Kapitalin e klasës së dytë ( 0.6% e mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor)
5	Provizionet shtesë ndaj humbjeve të pritura, që lidhen me portofoliot sipas qasjes së vlerësimeve të brendshme, që do të përfshihen në Kapitalin e klasës së dytë
	<b>Për portofoliot sipas qasjes së standardizuar</b>



6	Gjithsej provizionet bruto që kualifikohen për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë
7	Limiti maksimal për përfshirjen e provizioneve në Kapitalin e klasës së dytë (1.25% të mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor)
8	Gjithsej provizionet sipas qasjes së standardizuar të përfshira në Kapitalin e klasës së dytë
9 = 5+8	<b>Gjithsej shuma e provizioneve që duhet të përfshihen në Kapitalin e klasës së dytë</b>

**Tabela 3. Definicioni i kapitalit – llogaritja e interesit pakicë**

<b>Rreshti</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1	Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë i filialës pas zbritjeve Neni 17 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
2	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e paspërndara në pronësi të grupit, bruto nga të gjitha zbritjet Neni 17 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
3	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e paspërndara në pronësi të palëve të treta bruto nga të gjitha zbritjet Neni 17 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
4	Gjithsej Kapitali i klasës së parë (Kapitali bazë i klasës së parë + Kapitali shtesë i klasës së parë) i filialës neto nga zbritjet Neni 18 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
5	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e paspërndara në pronësi të grupit, bruto nga të gjitha zbritjet Neni 18 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
6	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e paspërndara në pronësi të palëve të treta bruto nga të gjitha zbritjet Neni 18 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
7	Gjithsej Kapitali (Kapitali bazë i klasës së parë + Kapitali shtesë i klasës së parë + Kapitali i klasës së dytë) i filialës neto nga zbritjet Neni 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave

8	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e pashpërndara në pronësi të grupit bruto nga të gjitha zbritjet Neni 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
9	Kapitali i paguar plus rezervat/fitimet e pashpërndara në pronësi të palëve të treta bruto nga të gjitha zbritjet Neni 19 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave
10	Gjithsej mjetet e peshuara me rrezik të filialës
11	Mjetet e peshuara me rrezik të grupit të konsoliduar që janë të lidhura me filialën (d.m.th., mjetet e peshuara me rrezik të filialës me përjashtim të transaksioneve brenda grupit)
12 = min (10,11)	Vlera më e ulët e mjeteve të peshuara me rrezik të filialës dhe pjesëmarrja në mjetet e peshuara me rrezik të konsoliduara
13	<b>Kapitali Bazë i Klasës së parë</b>
14	Teprica e Kapitalit Bazë të klasës së parë të filialës; nga e cila
15	Shuma që u atribuohet palëve të treta
16	Gjithsej Kapitali bazë i klasës së parë i filialës i mbajtur nga palët e treta minus teprica që u atribuohet investitorëve si palë të treta
17	<b>Gjithsej Kapitali i klasës së parë</b>
18	Teprica e Kapitalit të klasës së parë të filialës; nga e cila
19	Shuma që u atribuohet palëve të treta
20 = 6-19	Gjithsej Kapitali i klasës së parë i filialës i mbajtur nga palët e treta minus teprica që u atribuohet investitorëve si palët e treta
21	<b>Gjithsej Kapitali</b>
22	Teprica e gjithsej kapitalit të filialës; nga e cila
23	Shuma që u atribuohet palëve të treta
24 = 9-23	Gjithsej Kapitali i filialës i mbajtur nga palët e treta minus teprica që u atribuohet investitorëve si palët e treta

25	<b>Shuma e Kapitalit bazë të klasës së parë të mbajtur nga palët e treta për përfshirje në Kapitalin bazë të klasës së parë të konsoliduar</b>
26	<b>Shuma e Kapitalit të klasës së parë të mbajtur nga palët e treta për përfshirje në Kapitalin shtesë të klasës së parë të konsoliduar</b>
27	<b>Shuma e gjithsej Kapitalit të mbajtur nga palët e treta për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë të konsoliduar</b>

## **II. RREZIKU KREDITOR**

### **UDHËZIMET MBI RAPORTIMIN E SHUMAVE TË EKSPOZIMEVE TË PESHUARA ME RREZIK PËR RREZIKUN KREDITOR**

1. Fushëveprimi i formës së raportimit të rrezikut kreditor sipas qasjes së standardizuar përfshinë kërkesat për kapital për rrezikun kreditor në pajtim me nenet 40 deri 58 të Kapitullit III të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
2. Forma për raportimin e rrezikut kreditor sipas qasjes së standardizuar siguron informacionin e nevojshëm për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun kreditor sipas qasjes së standardizuar.

Në veçanti siguron informacionin e detajuar sa i përket:

- 2.1 shpërndarjes së vlerave të ekspozimeve sipas klasave të ndryshme të ekspozimeve, peshave të rrezikut dhe klasave të ekspozimit;
  - 2.2 shumës dhe llojit të teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor të përdorura për zvogëlimin e rreziqeve.
3. Sipas nenit 42 të kapitullit III të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave çdo ekspozim duhet të caktohet në njërën nga klasat e ekspozimeve sipas qasjes së standardizuar në mënyrë që të llogariten kërkesat për kapital.
  4. Informacioni për rrezikun kreditor sipas qasjes së standardizuar kërkohet të raportohet nga bankat për gjithsej klasat e ekspozimeve dhe ndaras për secilën klasë të ekspozimit siç definohet për qasjen e standardizuar.
  5. Megjithatë, zërat në vijim nuk janë në kuadër të fushëveprimit të rrezikut kreditor sipas qasjes së standardizuar:
    - 5.1 Ekspozimet e caktuara në klasën e ekspozimit “zërat që përfaqësojnë pozicionet e sekjuritizimit”
    - 5.2 Ekspozimet e zbritura nga kapitali rregullator.

6. Në mënyrë që të sigurohet një kategorizim konsistent i ekspozimeve në klasat e ndryshme të ekspozimeve siç definohet në Nenin 42 të kapitullit III të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, duhet të aplikohet qasja vijuese si më poshtë:

6.1. Së pari, ekspozimi origjinal para aplikimit të faktorëve konvertues klasifikohet në klasën përkatëse (origjinale) të klasës së ekspozimit, pa paragjykuar trajtimin specifik (peshën e rrezikut) që do të marrë çdo ekspozim individualisht brenda klasës së caktuar të ekspozimit.

6.2. Së dyti, ekspozimet mund të rishpërndahen në klasat tjera të ekspozimeve për arsye të aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor me efektet e zëvendësimit në ekspozim (p.sh., garancitë) përmes hyrjeve dhe daljeve.

7. Në fazën e parë, për qëllim të klasifikimit të ekspozimit origjinal para aplikimit të faktorëve konvertues, teknikat e zbutjes së rrezikut kreditor që lidhen me ekspozimin nuk duhet të merren parasysh (në mënyrë eksplicite duhet të merren parasysh në fazën e dytë) përveç nëse efekti i mbrojtjes është pjesë përbërëse e definicionit të klasës së ekspozimit sikurse është rasti i klasës së ekspozimit “ ekspozimet e siguruara me kolateral të paluajtshëm”.

Meqenëse nuk ekziston ndonjë kriter për ndarjen e klasave të ekspozimeve, mund të nënkuptohet që një ekspozim potencialisht mund të klasifikohet në klasa të ndryshme të ekspozimeve nëse nuk përcaktohet prioriteti në kriterin e vlerësimit për klasifikimin. Rastet më të shpeshta ndodhin ndërmjet ekspozimeve ndaj institucioneve dhe korporatave me vlerësim kreditor afatshkurtër dhe ekspozimeve ndaj institucioneve / ekspozimeve ndaj korporatave. Në rastin konkret është e qartë se ekziston një prioritet implicit që duhet të vlerësohet fillimisht nëse ekspozimi i caktuar i plotëson kushtet që të caktohet në klasën “ekspozimet afatshkurtra ndaj institucioneve dhe korporatave” dhe pastaj aplikohet procesi i njëjtë për ekspozimet ndaj institucioneve dhe ekspozimeve ndaj korporatave.

Për një raportim homogjen dhe të krahasueshëm është e nevojshme të specifikohet kriteri i vlerësimit të prioritetit për caktimin e ekspozimit origjinal para aplikimit të faktorëve konvertues sipas klasave të ekspozimit, pa paragjykim të trajtimit specifik (peshës së rrezikut) që çdo ekspozim specifik do të marrë në kuadër të klasës së caktuar të ekspozimit. Kriteri i prioritetit i paraqitur më poshtë duke e përdorur skemën është bazuar në vlerësimin e kushteve të paraqitura në mënyrë eksplicite në kapitullin III të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.














Një klase të ekspozimit do t’i jepet përparësi ndaj klasave të tjera në radhitjen e vlerësimit në skemën e vendimmarrjes (d.m.th., fillimisht duhet të vlerësohet nëse ekspozimi mund të caktohet në të, pa paragjykuar rezultatin e atij vlerësimi) nëse potencialisht asnjë ekspozim nuk do mund të caktohet në të. Ky do të ishte rasti kur në mungesë të kriterit të prioritetizimit një klasë e ekspozimit do të ishte në mesin e të tjerave. Si e tillë kriteret e përshkruara në formë grafike në skemën pasuese vendimmarrëse do të aplikohen sipas procesit vijues.


8. Radhitja e vlerësimit në skemën vendimmarrëse ndjek radhitjen në vijim:

8.1. Ekspozimet e kategorizuara me rrezik të lartë;

- 8.2. Ekspozimet ndaj ekuitetit të entiteteve;
  - 8.3. Ekspozimet jo-performuese;
  - 8.4. Ekspozimet ndaj fondeve investive;
  - 8.5. Ekspozimet e siguruara me kolateral të paluajtshëm;
  - 8.6. Ekspozimet tjera;
  - 8.7. Ekspozimet ndaj institucioneve dhe korporatave me vlerësime kreditore afatshkurta;
  - 8.8. Të gjitha klasat tjera të ekspozimeve (klasat e ekspozimeve të veçanta) që përfshijnë:
    - 8.8.1 Ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
    - 8.8.2 Ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
    - 8.8.3 Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik;
    - 8.8.4 Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
    - 8.8.5 Ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare;
    - 8.8.6 Ekspozimet ndaj institucioneve;
    - 8.8.7 Ekspozimet ndaj korporatave; dhe
    - 8.8.8 Ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme
- 9 Në fazën e dytë, për shkak të aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor me efekt të zëvendësimit, ekspozimet duhet të zhvendosen në klasën e ekspozimit të ofruesit të mbrojtjes kreditore.
- 10 Kapitulli IV i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave rregullon efektet e teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor.
- 11 Ekspozimet për huamarrësit (kundërpala direkte) dhe ofruesit e mbrojtjes kreditore të cilat janë caktuar për klasën e njëjtë të ekspozimit duhet të raportohen si fluks hyrës si dhe fluks dalës në të njëjtën klasë të ekspozimit.
- 12 Lloji i ekspozimit nuk ndryshon për shkak të mbrojtjes kreditore të pa financuar. Nëse një ekspozim është i siguruar nga një mbrojtje kreditore e pa financuar, pjesa e siguruar raportohet si fluks dalës. p.sh., në klasën e ekspozimit të huamarrësit dhe si një fluks hyrës në klasën e ekspozimit të ofruesit të mbrojtjes kreditore. Megjithatë, lloji i ekspozimit nuk ndryshon për shkak të ndryshimit të klasës së ekspozimit.
- 13 Për klasën e ekspozimit “Institucionet” dhe “Korporatat” raportimi i ekspozimeve brenda grupit duhet të raportohet në klasën e ekspozimit përkatës ku do të raportoheshin sikurse të mos ishin ekspozime brenda grupit. Prandaj, raportimi i ekspozimeve brenda grupit duhet të merr parasysh llojet e ndryshme të klasave të ekspozimeve brenda grupit, d.m.th., nëse kundërpala është një institucion duhet të caktohet te klasa e ekspozimit “institucionet”, por nëse kundërpala është korporatë, ekspozimi i kësaj kundërpale duhet të caktohet te klasa e ekspozimit “korporatat”. Gjithashtu edhe ekspozimet tjera duhet të raportohen në klasat përkatëse të ekspozimeve ku do të raportoheshin nëse do të ishin ekspozime brenda grupit.

SKEMA VENDIMMARRËSE MBI CAKTIMIN E EKSPOZIMIT ORIGINAL PARA APLIKIMIT TË FAKTORËVE KONVERTUES PËR KLASAT E EKSPOZIMEVE TË QASJES SË STANDARDIZUAR SIPAS RREGULLORES PËR ADEKUATSHMËRINË E KAPITALIT TË BANKAVE

Ekspozimi original para aplikimit të faktorëve konvertues		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.11)?	PO 	Ekspozimet e kategorizuara me rrezik të lartë
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.14)?	PO 	Ekspozimet ndaj ekuitetit të entiteteve
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.10)?	PO 	Ekspozimet jo-performuese
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.13)?	PO 	Ekspozimet ndaj fondeve investive
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.9)?	PO 	Ekspozimet e siguruar me kolateral të paluajtshëm
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.15)?	PO 	Ekspozimet tjera
JO 		
A i plotëson kriteret për tu caktuar në klasën e ekspozimit të nenit 42 pika (1.12)?	PO 	Ekspozimet ndaj institucioneve dhe korporatave me vlerësime kreditore afatshkurta

JO 		
<p>Klasat e ekspozimeve më poshtë janë të ndara ndërmjet vete. Caktimi në njëjërën nga këto klasa është i drejtpërdrejtë.</p> <p>Ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore  Ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale  Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik  Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit  Ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare  Ekspozimet ndaj institucioneve  Ekspozimet ndaj korporatave dhe  Ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme</p>		

**Tabela 4. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për mjetet e peshuara me rrezik për rrezikun kreditor dhe teknikat e zbutjes së rrezikut kreditor**

Kolonat	
1	Ekspozimet bilancore
2 – 9	Rregullimet e vlerës për ekspozimet bilancore
2	Provizionet
3-5	Teknikat për zbutjen e rrezikut kreditor
3	Paraja e gatshme
4	Letrat me vlerë
5	Garancitë
6	Zbritjet tjera
7	Ekspozimet e zbritura nga kapitali rregullator
8 = 3+4+5	Gjithsej flukset dalëse
9	Gjithsej flukset hyrëse
10 = 1-2-6-7-8+9	Ekspozimet bilancore (pas rregullimit të vlerave)
11	Ekspozimet jashtëbilancore (para FKK)
12	Ekspozimet jashtëbilancore (pas FKK)
13 – 20	Rregullimet e vlerës për ekspozimet jashtë bilancore
13	Provizionet
14 – 16	Teknikat për zbutjen e rrezikut kreditor
14	Paraja e gatshme
15	Letrat me vlerë
16	Garancitë
17	Zbritjet tjera
18	Ekspozimet e zbritura nga kapitali rregullator
19 = 14+15+16	Gjithsej flukset dalëse

20	Gjithsej flukset hyrëse
21 = 12-13-17-18-19+20	Ekspozimet jashtëbilancore (pas rregullimit të vlerave)
22	MPRr për ekspozimet bilancore
23	MPRr për ekspozimet jashtë bilancore
24 = 22+23	Gjithsej MPRr për ekspozimet bilancore dhe jashtëbilancore
25 = 24*% e kapitalit të kërkuar	Kërkesat për kapital

### III. RREZIKU I TREGUT

#### UDHËZIMET MBI RAPORTIMIN E FORMAVE PËR RREZIKUN E TREGUT

1. Këto udhëzime i referohen plotësisht të formave të raportimit për llogaritjen e kërkesave për kapital sipas qasjes së standardizuar për rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit, rrezikut ndaj instrumenteve të kapitalit, rrezikut nga pozicionet në mallra, rrezikut të këmbimit valutor dhe rrezikut të shlyerjes/dërgesës.
2. Rreziku i pozicionit në një instrument të borxhit apo të kapitalit (ose derivativi të borxhit apo të kapitalit) duhet të ndahet në dy komponentë në mënyrë që të llogaritet kërkesa e kapitalit për të.
3. Komponenti i parë duhet të jetë për rrezikun specifik - që është rreziku i ndryshimit të çmimit në instrumentin e caktuar për shkak të faktorëve që lidhen me emetuesin e atij instrumenti ose në rastet e instrumentit financiar derivativ, emetuesi i instrumentit bazë.
4. Komponenti i dytë duhet të përfshijë rrezikun e përgjithshëm - që është rreziku i ndryshimit të çmimit në instrument (në rastet e instrumenteve të tregtueshme të borxhit apo instrumenteve derivative të borxhit) për shkak të ndryshimit në nivelin e normave të interesit ose (në rastet e instrumenteve të kapitalit apo instrumenteve derivative të kapitalit) për shkak të lëvizjeve të mëdha të tregjeve të kapitalit që nuk lidhet me ndonjë element specifik të letrave me vlerë individuale.

Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit

#### Shënime të përgjithshme

5. Kjo formë përfshinë pozicionet dhe kërkesat për kapital të lidhura me rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit sipas qasjes së standardizuar.
6. Rreziqet e ndryshme dhe metodat janë të përcaktuara në kolonat dhe rreshtat më poshtë.

**Tabela 5. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit sipas qasjes së standardizuar**



<b>Kolonat</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1-2	<p><b><u>TË GJITHA POZICIONET (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Këto janë pozicionet bruto që nuk janë netuar nga instrumentet por që përjashtojnë pozicionet nënshkruese të cilat janë nënshkruar apo nën-nënshkruar nga palët e treta.</p>
3-4	<p><b><u>POZICIONET NETO (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Nenet 74 deri 76 dhe neni 82 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Lidhur me dallimet në mes të pozicioneve të gjata dhe të shkurta, shih nenin 75 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
5	<p><b><u>POZICIONET SUBJEKT I NGARKESËS SË KAPITALIT</u></b></p> <p>Pozicionet neto të llogaritura sipas qasjeve të ndryshme për të cilat zbatohet ngarkesa në kapital.</p>
6	<p><b><u>KËRKESAT PËR KAPITAL</u></b></p> <p>Ngarkesat në kapital për çdo pozicion përkatës.</p>
7	<p><b><u>GJITHSEJ SHUMA E EKSPONIMIT ME RREZIK</u></b></p> <p>Rezultati i shumëzimit të kërkesës për kapital me 8.33.</p>
<b>Rreshtat</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1-51	<p><b><u>INSTRUMENTET E TREGTUESHME TË BORXHIT NË LIBRIN TREGTAR</u></b></p> <p>Pozicionet në instrumentet e tregtueshme të borxhit në librin tregtar dhe kërkesa për kapital që korrespondon me rrezikun e pozicionit raportohen varësisht nga kategoria e rrezikut, maturiteti dhe qasja e përdorur.</p>
2	<p><b><u>RREZIKU I PËRGJITHSHËM</u></b></p>
3	<p>Derivativët</p> <p>Derivativët e përfshirë në llogaritjen e rrezikut nga ndryshimi i normës së interesit të pozicioneve të librit tregtar në pajtueshmëri me Nenet 75 deri 78 të</p>

	Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, nëse është e aplikueshme.
4	Asetet dhe detyrimet tjera  Instrumentet tjera përveç derivativëve që janë përfshirë në llogaritjen e rrezikut nga ndryshimi i normës së interesit të pozicioneve në librin tregtar.
5-31	<b><u>QASJA E BAZUAR NË MATURITET</u></b>  Pozicionet në instrumentet e tregtueshme të borxhit që janë subjekt i qasjes së bazuar në maturitet sipas Nenit 86 par. 8 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe kërkesat përkatëse për kapital të përcaktuara në Nenin 86 par. 9 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Pozicioni duhet të ndahet sipas zonave 1,2 dhe 3 dhe zonat duhet të ndahen sipas maturitetit të instrumenteve.
32-40	<b><u>RREZIKU I PËRGJITHSHËM- QASJA E BAZUAR NË KOHËZGJATJE</u></b>  Pozicionet në instrumentet e tregtueshme të borxhit që janë subjekt i qasjes së bazuar në kohëzgjatje në pajtueshmëri me Nenin 87 par. 1 deri 5 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe kërkesa përkatëse për kapital të përcaktuar në Nenin 87 par. 6 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Pozicioni duhet të ndahet në zonat 1,2 dhe 3.
41	<b><u>RREZIKU SPECIFIK</u></b>  Shuma e vlerave të raportuara në rreshtin 41.  Pozicionet në instrumentet e tregtueshme të borxhit që janë subjekt i ngarkesës së kapitalit për rrezikun specifik dhe ngarkesës përkatëse të kapitalit në pajtueshmëri me Nenin 5 dhe Nenin 81, Nenin 83 dhe Nenin 84 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
42-49	<b><u>Kërkesa për kapital për instrumentet e borxhit që nuk janë pjesë e procesit të sekjuritizimit</u></b>  Shuma e vlerave të raportuara në rreshtat 42 deri 49.

	Nëse rreziku i përgjithshëm i pozicioneve të normave të interesit është mbrojtur nga një derivativ kreditor, duhet të aplikohen Nenet 93 dhe 94 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
50-51	<b><u>KËRKESAT SHITESË PËR OPSIONET (RREZIOET JO-DELTA)</u></b>  Neni 76 par.4 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave .  Kërkesat shtesë për opsionet që lidhen me rreziqet jo-delta duhet të raportohen sipas metodës së përdorur për llogaritje..

Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit për instrumentet e kapitalit

Shënime të përgjithshme

7. Kjo formë përfshinë informata rreth pozicioneve dhe kërkesave përkatëse për kapital për rrezikun e pozicionit në instrumentet e kapitalit që mbahen në librin tregtar dhe që trajtohen sipas qasjes së standardizuar.

**Tabela 6. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për rrezikun e pozicionit për instrumentet e kapitalit**

Kolonat	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1-2	<b><u>TË GJITHA POZICIONET (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b>  Këto janë pozicionet bruto që nuk janë netuar nga instrumentet por që përjashtojnë pozicionet nënshkruese që janë të nënshkruara apo të nënshkruara nga palët e treta.
3-4	<b><u>POZICIONET NETO (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b>  Nenet 74, 76, 79, 88 dhe 92 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
5	<b><u>POZICIONET SUBJEKT I NGARKESËS NË KAPITAL</u></b>

	Pozicionet neto të llogaritura sipas qasjeve të ndryshme për të cilat aplikohet ngarkesa në kapital. Ngarkesa në kapital duhet të llogaritet veçmas për secilin treg kombëtar ndaras.
6	<b><u>KËRKESAT PËR KAPITAL</u></b>  Kërkesat për kapital për çdo pozicion përkatës.
7	<b><u>GJITHSEJ SHUMA EKSPONIMIT ME RREZIK</u></b>  Neni 5 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Rezultat i shumëzimit të kërkesës për kapital me 8.33.

<b>Rreshtat</b>	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1-9	<b><u>INSTRUMENTET E KAPITALIT NË LIBRIN TREGTAR</u></b>  Kërkesat për kapital për rrezikun e pozicionit sipas Nenit 5 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe nën-kapitullin III.
2-6	<b><u>RREZIKU I PËRGJITHSHËM</u></b>  Pozicionet në instrumentet e kapitalit që janë subjekt i rrezikut të përgjithshëm në pajtueshmëri me nenin 90 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe kërkesa përkatëse për kapital në pajtueshmëri me nën-kapitullin III të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.  Të dy ndarjet (3/4 në rreshta si dhe 3/4 në kolona) janë ndarje që lidhen me të gjitha pozicionet që janë subjekt i rrezikut të përgjithshëm.  Rreshtat 3 dhe 4 kërkojnë informacione për ndarjet sipas instrumenteve.  Vetëm ndarja në rreshtat 3 dhe 4 përdoret si bazë për llogaritjen e kërkesave për kapital.
3	Derivativët

	<p>Derivatívët e përfshirë në llogaritjen e rrezikut të instrumenteve të kapitalit për pozicionet në librin tregtar në pajtueshmëri me nenet 76 dhe 79, nëse është e aplikueshme.</p>
4	<p>Asetet dhe detyrimet tjera</p> <p>Instrumentet tjera përveç derivativëve që janë përfshirë në llogaritjen e rrezikut të instrumenteve të kapitalit për pozicionet në librin tregtar.</p>
5	<p><b><u>Kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve të tregtuara në bursë që janë gjerësisht të diversifikuara dhe janë subjekt i qasjes së caktuar.</u></b></p> <p>Kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve të tregtuara në bursë që janë mjaftë të diversifikuara dhe janë subjekt i qasjes së caktuar në pajtueshmëri me Nenin 91 par.1 dhe 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Këto pozicione janë subjekt vetëm i rrezikut të përgjithshëm dhe rrjedhimisht nuk duhet të raportohen në reshtin 7 të formularit.</p>
6	<p><b><u>Instrumentet tjera të kapitalit që nuk janë kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve të tregtuara në bursë dhe mjaftë të diversifikuara</u></b></p> <p>Pozicionet tjera të instrumenteve të kapitalit që janë subjekt i rrezikut specifik dhe kërkesave përkatëse për kapital në pajtueshmëri me Nenet 90 dhe 91 par.1 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
7	<p><b><u>RREZIKU SPECIFIK</u></b></p> <p>Pozicionet në instrumentet e kapitalit që janë subjekt i rrezikut specifik dhe kërkesës përkatëse për kapital në pajtueshmëri me Nenet 89 dhe 91 par. 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
8-9	<p><b><u>KËRKESAT SHITESË PËR OPSIONET (RREZIQET JO-DELTA)</u></b></p> <p>Neni 76 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> <p>Kërkesat shtesë për opsonet që lidhen me rreziqet jo-delta duhet të raportohet sipas metodës së përdorur për llogaritje.</p>

Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e mallrave (MKR SA COM)

Shënime të përgjithshme:

8. Kjo formë përfshinë informacionin për pozicionet e mallrave dhe kërkesat përkatëse për kapital sipas qasjes së standardizuar.

**Tabela 7. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për pozicionet e mallrave dhe kërkesat për kapital sipas qasjes së standardizuar**

<b>Kolonat</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1-2	<p><b><u>TË GJITHA POZICIONET (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Bruto pozicionet e gjata/të shkurta që konsiderohen si pozicione në mallin e njëjtë sipas Nenit 97 par. 1 dhe 4 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, shih gjithashtu nenin 99 par.1 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
3-4	<p><b><u>POZICIONET NETO (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Siç janë definuar në Nenin 97 par. 3 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
5	<p><b><u>POZICIONET SUBJEKT I NGARKESËS PËR KAPITAL</u></b></p> <p>Pozicionet neto të llogaritura sipas qasjeve të ndryshme për të cilat aplikohet ngarkesa në kapital.</p>
6	<p><b><u>KËRKESAT PËR KAPITAL</u></b></p> <p>Kërkesa për kapital për çdo pozicion përkatës sipas nën kapitullit VI.</p>
7	<p><b><u>GJITHSEJ SHUMA EKSPONIMIT ME RREZIK</u></b></p> <p>Neni 5 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave - Rezultat i shumëzimit të kërkesës për kapital me 8.33.</p>

Rreshtat	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1	<p><b><u>GJITHSEJ POZICIONET NË MALLRA</u></b></p> <p>Pozicionet në mallra dhe kërkesa përkatëse për kapital për rrezikun e tregut në pajtueshmëri me Nenin 5 të dhe nën-kapitullin VI të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
2-6	<p><b><u>POZICIONET SIPAS KATEGORISË SË MALLRAVE</u></b></p> <p>Për qëllime të raportimit mallrat duhet të grupohen në katër grupe kryesore të mallrave sipas Tabelës 2 të Nenit 101 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
7-19	<p><b><u>QASJA SIPAS SHKALLËS SË MATURITETIT</u></b></p> <p>Pozicionet në mallra që janë subjekt i qasjes sipas shkallës së maturitetit, siç përcaktohet në Nenin 99 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
20-32	<p><b><u>QASJA E ZGJERUAR E SHKALLËS SË MATURITETIT</u></b></p> <p>Pozicionet në mallra që janë subjekt i qasjes së zgjeruar të shkallës së maturitetit, siç përcaktohet në Nenin 101 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
33-35	<p><b><u>QASJA E THJESHTË</u></b></p> <p>Pozicionet në mallra që janë subjekt i qasjes së thjeshtë, siç përcaktohet në Nenin 100 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>
36-37	<p><b><u>KËRKESAT SHITESË PËR OPSIONET (RREZIOET JO-DELTA)</u></b></p> <p>Neni 98 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p>

	Kërkesat shtesë për opsionet që lidhen me rreziqet jo-delta duhet të raportohen sipas metodës së përdorur për llogaritje.
--	---

## **Rreziku i Shlyerjes/Dërgesës (CR SETT)**

### Udhëzime të përgjithshme

9. Kjo formë raportimi kërkon shpalesjen e informacionit në “librin tregtar” të transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e shlyerjes sipas nenit 103.

10. Bankat raportojnë në formën CR SETT informacionin që lidhet me rrezikun e shlyerjes/dorëzimit në lidhje me instrumentet e borxhit, ekuitetin, derivativët, valutat e huaja dhe mallrat të mbajtura me qëllim tregtimi (në librin tregtar).

11. Në rast se këto transaksione nuk janë shlyer në datën e shlyerjes (datën e maturimit), banka duhet të llogarisë ndryshimin e çmimit ndaj të cilit ekspozohet. Ky ndryshim llogaritet si diferencë mes çmimit të përcaktuar në kontratë dhe vlerës aktuale në treg të instrumenteve financiare, valutave apo mallrave (ang. commodities) për të marrë (dorëzuar), atëherë kur kjo diferencë në çmim është pozitive, pra kur banka humbë nga kjo diferencë.

12. Bankat shumëzojnë këtë diferencë me faktorët përkatës të paraqitur në Tabelën 1 të nenit 103 të Rregullorës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave për të përcaktuar kërkesën për kapital.

13. Vlera e peshuar pastaj shumëzohet me 12% për të llogaritur kërkesat për kapital rregullator për rrezikun e shlyerjes/dërgesës.

**Tabela 8. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për rrezikun e shlyerjes / dërgesës**

Kolona	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1	<p><b><u>TRANSAKSIONET E PASHLYERA SIPAS ÇMIMIT TË KONTRATËS</u></b></p> <p>Bankat raportojnë në kolonën 1 transaksionet e pashlyera pas datës së kontratës sipas çmimit të kontratës</p> <p>Këto përfshihen të gjitha transaksionet e pashlyera, pavarësisht nëse banka është në fitim apo humbje pas datës së shlyerjes.</p>
2	<p><b><u>Data e shlyerjes sipas kontratës</u></b></p> <p>Këtu shënohet data e shlyerjes për të gjitha transaksionet e pashlyera.</p>



3	<p><b><u>Transaksionet e pashlyera sipas çmimit të tregut</u></b></p> <p>Këtu shënohet vlera e transaksioneve të pashlyera sipas çmimit aktual të tregut .</p>
4	<p><b><u>Cmimi i tregut me datë _____</u></b></p> <p><b><u>Këtu shënohet data sipas të cilës është llogaritur vlera me çmim të tregut të transaksionit të pashlyer</u></b></p>
5	<p><b><u>DIFERENCA NË ÇMIM MES ÇMIMIT TË KONTRATËS DHE ÇMIMIT TË TREGUT</u></b></p> <p>Në përputhje me Nenin 103 të Rregullorës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, bankat raportojnë në kolonën 5 diferencën mes vlerës së transaksionit sipas çmimit të kontratës ndaj çmimit aktual në treg për vlerën e instrumentit të borxhit, ekuitetit, valutës së huaj, derivativit apo mallrave, atëherë kur banka nga kjo diferencë mund të pësojë humbje.</p> <p>Në kolonën 5 raportohen vetëm transaksionet e pashlyera kur banka realizon humbje.</p>
6	<p><b><u>GJITHSEJ EKSPOZIMI I PESHUAR ME RREZIK</u></b></p> <p>Sipas Nenit 103 në Tabelën 1 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, këtu bankat raportojnë ekspozimet e peshuara me rreziqet përkatëse për transaksionet e pashlyera.</p>
7	<p><b><u>KËRKESA PËR KAPITAL</u></b></p> <p>Për të gjetur vlerën e ekspozimit ndaj rrezikut të shlyerjes, bankat shumëzojnë shumën e ekspozimit të peshuar me rrezik në kolonën 6 me 12%.</p>

<b>Rreshti</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1	<p><b><u>Totali i transaksioneve të pashlyera në Librin Tregtar</u></b></p> <p>Në rreshtin 1 bankat raportojnë informacion të përmbledhur që ka të bëjë me rrezikun e shlyerjes/dërgesës për pozicionet e raportuara në librin tregtar.</p> <p>Në rreshtin 1, kolona 1 bankat raportojnë shumën e transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes (kontratës) sipas vlerës përkatëse në kontratë.</p> <p>Në rreshtin 1, kolona 5, bankat raportojnë shumën e diferencës së vlerës së ekspozuar mes çmimit të kontratës dhe çmimit të tregut, atëherë kur banka realizon humbje.</p>

	Në rreshtin 1, kolona 6, bankat raportojnë shumën e ekspozimeve të peshuara me faktorët përkatës sipas numrit të ditëve në vonesat e transaksioneve të pashlyera (sipas Tabelës 1 të Nenit 103 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave).
2 deri 6	<p><b><u>Transaksione të pashlyera deri në 4 ditë vonesë (me faktor 0%)</u></b></p> <p><b><u>Transaksione të pashlyera ndërmjet 5 dhe 15 ditësh (me faktor 8%)</u></b></p> <p><b><u>Transaksione të pashlyera ndërmjet 16 dhe 30 ditësh (me faktor 50 %)</u></b></p> <p><b><u>Transaksione të pashlyera ndërmjet 31 dhe 45 ditësh (me faktor 75%)</u></b></p> <p><b><u>Transaksione të pashlyera mbi 46 ditë e më tepër (me faktor 100%)</u></b></p> <p>Për transaksionet e pashlyera në më pak se 5 ditë pune pas datës së shlyerjes nuk kërkohet kapital shtesë</p>

### **Rreziku i Tregut: Rreziku i Këmbimit Valutor në Librin Tregtar**

14. Llogaritja e kapitalit rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit duhet të bëhet në përputhje me Nenin 105 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Nëse gjithsej pozicioni neto i hapur valutor dhe gjithsej pozicioni i hapur neto i arit të bankës tejkalon 2% të gjithsej kapitalit rregullator, banka duhet të shumëzojë shumën e pozicionit neto të hapur në valutë të huaj dhe pozitën e saj neto prej ari me 12%, në mënyrë që të llogaritet kërkesa e kapitalit kundrejt rrezikut të këmbimit valutor në librin tregtar.

15. Bankat duhet të raportojnë secilin pozicion në valutë të huaj (përfshirë edhe valutën raportuese) dhe për ari si dhe kërkesën përkatëse për kapital për rrezikun e këmbimit valutor sipas metodës së thjeshtë. Rreshtat 6 deri 37 duhet të plotësohen edhe në rastet kur bankat mund të jenë të përjashtuara të llogarisin kapitalin rregullator për ato valuta. Formulari për menaxhimin e rrezikut të këmbimit valutor fillon të plotësohet duke filluar nga rreshti 9 deri 37 të kolonës 2 dhe 3.

### **Valuta Euro**

16. Në rreshtin dhe kolonat në vijim, bankat raportojnë edhe pozicionet në valutën raportuese euro, edhe pse euro nuk është subjekt i kërkesave për kapital.

**Tabela 9. Udhëzimet lidhur me pozicionet specifike për rrezikun e këmbimit valutor në Librin Tregtar**

<b>Kolona</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1	Kodet për secilën valutë përkatëse.

2 dhe 3	<p><b><u>TË GJITHA POZICIONET (E GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Këtu raportohen bruto pozicionet e gjata dhe të shkurta sipas Nenit 105 dhe Nenit 106 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, pozicionet e mbrojtura (hedged) ndaj efekteve negative kundrejt kursit të këmbimit, si dhe pozicionet që me lejen e BQK-së mund të hiqen nga kalkulimi kapitalit.</p> <p>Pozicionet e gjata në secilën valutë = Shuma e pozicionit <i>Spot</i> (të gjatë) + pozicioni <i>forward</i> (i gjatë) + Pozicioni <i>Options</i> (i gjatë).</p> <p>Pozicionet e shkurta në secilën valutë = Shuma e pozicionit <i>Spot</i> (të shkurtë) + pozicioni <i>forward</i> (të shkurtë) + Pozicioni <i>Options</i> (i shkurtë).</p>
4 dhe 5	<p><b><u>POZICIONET NETO (TË GJATA DHE TË SHKURTA)</u></b></p> <p>Pozicionet neto llogariten për secilën valutë, prandaj në të njëjtën kohë mund të ketë edhe pozicione të gjata edhe të shkurta.</p> <p>Bankat plotësojnë pozicionet neto për çdo valutë në rreshtat 9 deri 37 si diferencë në mes të pozicionit të gjatë dhe atij të shkurtë.</p>
6	<p>Bankat raportojnë shumën e kapitalit të kërkuar për pozicionet në valutat e huaja, ari dhe opsionet (rreziqet jo-delta), ku paraprakisht secila prej tyre shumëzohet me 12% (si kërkesë kapitali).</p>
7	<p>Bankat llogarisin ekspozimin e peshuar me rrezik duke shumëzuar vlerën në kolonën 6, rreshtin 1 me 8.33.</p>
<b>Rreshtat</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1	<p><b><u>GJITHSEJ POZICIONET NË VALUTA TË HUAJA DHE NË ARI</u></b></p> <p>Këtu raportohen pozicionet në valuta të huaja dhe në ari dhe kërkesat përkatëse për kapital sipas Nenit 106 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave .</p>
2	<p><b><u>GJITHSEJ POZICIONET NË VALUTA TË HUAJA</u></b></p>

	Këtu raportohen pozicionet në valuta të huaja dhe kërkesat përkatëse për kapital sipas Nenit 106 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
3	<b><u>ARI</u></b>  Këtu raportohet pozicioni në ari.
4	<b><u>KËRKESAT SHITESË PËR OPSIONET (RREZIKU JO-DELTA)</u></b>  Kërkesat shtesë për opsonet (options) për rreziqet jo-delta duhet të raportohen sipas metodës së përshkruar në Nenin 102 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
5 (6, 7, 8)	<b><u>Ndarja e gjithsej pozicioneve (përfshirë edhe valutën raportuese) sipas llojit të ekspozimit</u></b>  Gjithsej pozicionet në valuta të huaja duhet të ndahen sipas llojit të ekspozimit: instrumente financiare, derivativë apo zëra jashtë-bilancor.
9 deri 37	<b><u>POZICIONET NË VALUTA TË HUAJA</u></b>  Të gjitha valutat (në pozicione të gjata ose të shkurta) duhet të plotësohen ndaras për secilën valutë.

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv